

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

Raport Vjetor 2021



TABELA E PËRMBAJTJES

1. PARATHËNJE

Observatori 9 vite prezent në Shqipëri.....	3
---	---

2. PROJEKTE 2021

Për krijimin, koordinimin, dhe zgjerimin e platformës mbrojtëse të shoqërisë civile për çështjet e ICPD dhe Objektivave të	5
Trajtimi i shkaqeve themelore të diskriminimit ndaj grave	5
Monitorimi i Medias mbi Dhunën ndaj Grave në Zgjedhjet në Shqipëri në Shqipëri.....	6
Fëmijët jashtë shkollës në Shqipëri	7
Qytetarë dhe Administratë publike për një qeverisje të mirë vendore	7
Riintegrim i qëndrueshëm me bazë komuniteti i shtetasve shqiptarë të kthyer nga <i>Siria</i>	8
Avancimi i Mbrojtjes dhe Kujdesit të Fëmijëve në Shqipëri 2019-2021.....	10

3. PARTNERËT E OBSERVATORIT

Kontributi i Partnerëve.....	11
------------------------------	----

»» PARATHËNJE

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve


Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori) në Shqipëri është një entitet joqeveritar i themeluar në 2013 si një rrjet i shoqërisë civile që synon të monitorojë situatën e fëmijëve dhe të rinjve në nivel kombëtar dhe strategjik. Degët e Observatorit janë në të gjithë vendin duke pasur dymbëdhjetë ekspertë rajonale (një në secilën bashki kryesore të vendit). Një staf i kualifikuar dhe me përvojë që ndodhet pranë çdo lokaliteti na jep mundësinë për të monitoruar situatën e fëmijëve e të rinjve dhe çështjet e të drejtave deri në nivel lokal.

Misioni ynë është të sigurojmë dinjitetin dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve në të gjithë Shqipërinë përmes vëzhgimit, kërkimit dhe analizës, komunikimit dhe avokimit; duke bashkëpunuar me aktorët /institucionet e tjera; dhe duke u përfshirë në fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi të publikut.

Përmes përfaqësuesve të tij në nivelin rajonal dhe në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore në bashki, Observatori mbledh informacionin statistikor nga të dhënat administrative të shëndetësisë, arsimit, mbrojtjes sociale dhe autoriteteve të tjera vendore. Duke përdorur softwerin DevInfo pasuria e informacionit statistikor është konsoliduar në një bazë të dhënash të disponueshme online në: <http://observator.org.al/odf2/qarqet-en.html>.

Deri më tani, baza e të dhënave të siguruara nga Observatori ka shërbyer si një burim unik informacioni në hartimin e një sërë ndërhyrjesh në nivel kombëtar dhe lokal nga institucione të ndryshme publike dhe OJF, si dhe ka shërbyer në planet e ndryshme strategjike të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare.

Duke përdorur këto të dhëna të marra nga institucione të ndryshme në nivel qendror dhe lokal, Observatori ka realizuar monitorime dhe vlerësime të ndryshme mbi situatën e fëmijëve dhe të rinjve në vend, duke kontribuar në hartimin e planeve të veprimit për fëmijët dhe të rinjtë në nivel kombëtar dhe lokal.



Një kontribut i rëndësishëm i prezencës së fortë të Observatorit në terren është aftësia e tyre për të advokuar me autoritetet qeveritare për të zgjeruar masat qendrore dhe lokale për adresimin e nevojave të fëmijëve dhe të rinjve në vend.



Përgjatë këtyre 7 viteve, Observatori ka qenë një nga nismëtarët dhe mobilizuesit e ngritjes dhe fuqizimit të rrjetit “Zëri i të rinjve”, duke mundësuar adresim politikash vendore për të rinjtë si dhe mbështjetës të aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare me dhe për të rinjtë.

Observatori është entiteti i parë dhe i vetëm në Shqipëri që ka ngritur zërin dhe ka ndërmarrë katër vjet angazhim intensiv në bërjen publike të çështjes së martesave nën moshë për të shpëtuar jetën e vajzave dhe djemve; Duke ngritur zërin nga nismat për ndërgjegjësimim në nivel lokal, deri në vëmendjen dhe politikën e qeverisë qendrore, duke e bërë pjesë të tryezave të diskutimit me përfaqësuesit e Ministrive të linjës.

Përmbajtja e këtij Raporti është përgjegjësi e Observatorit.

© Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky publikim duhet të dërgohen në:

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

Rruga “Brigada e VIII”, Pall. LID, K.1, Z.1, Tiranë, Shqipëri

Email: info@observator.org.al

Webmail: www.observator.org.al

»» PROJEKTE 2021

Për krijimin, koordinimin, dhe zgjerimin e platformës mbrojtëse të shoqërisë civile për çështjet e ICPD dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Observatori në saj të partneritetit me zyrën e UNFPA-së në Shqipëri, është i angazhuar që prej vitit 2017 për zbatimin e programit Zëri i të Rinjve: “Për krijimin, koordinimin dhe zgjerimin e platformës mbrojtëse të shoqërisë civile për çështjet e ICPD dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG)”. Në përbërje të këtij rrjeti janë 21 organizata dhe klube rinore të specializuara në fusha të ndryshme të shëndetit seksual dhe riprodhues, edukimit, shërbimeve sociale dhe shëndetësore, të drejtave të njeriut, punës në komunitet dhe punës me grupet e marginalizuara dhe në nevojë. Organizatat janë rrjetëzuar me njëra – tjetrën, duke zbatuar aktivitete të ndryshme në nivel kombëtar dhe rajonal. Përgjatë zbatimit të programit rinor në vitin 2019 dhe përmes ekspertizës së Observatorit, janë hartuar 15 **Plane aktivitetesh dhe buxhetore për të rinjtë në 15 Bashki** (Durrës, Fier, Maliq, Krujë, Dibër, Lezhë, Përmet, Urë Vajguore, Shijak, Shkodër, Roskovec, Belsh, Korçë, Pogradec dhe Cërrik,), duke dhënë sugjerime konkrete për iniciativat, programe që duhet të drejtohen nga bashkia duke marrë parasysh të gjitha



kompetencat sipas Ligjit 75/2019 “Për rininë”, Ligjit për qeverisjen lokale dhe Planit Kombëtar Veprimit për Rininë 2015-2020. Observatori monitoroi *Deklaratën e Angazhimeve për të Rinjtë*, e nënshkruar nga Bashkia e Tiranës që prej vitit 2015.

Gjithashtu janë hartuar 4 **Raporte monitoruese të planit buxhetor për rininë** në 4 bashki (Durrës, Përmet, Fier dhe Korçë).

Nga anketimet e të rinjve në lidhje me njohuritë mbi SDGs rezultoi që 1 në 10 të rinj kanë dëgjuar se çfarë janë SDGs. Përsa i përket njohurive të të rinjve mbi SHSR rezultoi se 1 në 7 të rinj nuk kanë marrë ndonjëherë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues. Programet më të preferuara që të rinjtë do të donin të përfitonin nga Bashkia janë; aktivitetet sociale, informuese, ndërgjegjësuese, trajnime, aktivitete argëtuese e sportive, aktivitete mjedisore dhe kulturore etj.

Për më shumë informacion të klikoni në linkun: <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2021/06/Permbledhja-mbi-punen-me-te-rinjte-ne-15-bashki.pdf>

Trajtimi i shkaqeve themelore të diskriminimit ndaj grave në Shqipëri

Projekti synon të eliminojë shkaqet themelore të diskriminimit ndaj vajzave dhe grave në Prrenjas dhe Devoll, për shkak të të cilave ato nuk kanë qasje të plotë në të drejtat e tyre si në sferën private ashtu edhe në atë publike. Normat dhe vlerat janë përgjegjëse për mbajtjen e grave në një pozitë vartëse, e cila gjithashtu ndikon negativisht në përparimin ekonomik dhe shoqëror të komunave. Projekti adreson pabarazitë shoqërore përmes 4 dimensioneve SIGI. Përmes 4 dimensioneve të njëjta, arsyet e diskriminimit ndaj vajzave dhe grave, mungesa e informacionit për gratë në lidhje me menaxhimin e mbeturinave dhe për një qasje më të mirë për vajzat dhe gratë në hapësira publike të sigurta, përfshirëse dhe të gjelbërta. Për ta arritur këtë, u trajnuan trajnerë të rinjsh, të cilët më pas do të transferojnë njohuritë e tyre brenda komunave të tyre përkatëse. Vendimmarrësit në nivelet lokale dhe kombëtare do të informohen dhe ndërgjegjësimi i tyre do të rritet me synimin për të siguruar integritimin gjinor në ligjet e reja, si dhe me zbatimin e atyre ekzistuese. Partnerë; Qendra Ballkanike për Bashkëpunim dhe Zhvillim (BCCD); Forumi për Zhvillim të Barabartë (Forum për enakopraven razvoj, društvo); Për më shumë informacion rreth nismës mund të lexoni raportin në linkun: <https://observator.org/al/wp-content/uploads/2021/02/Shqip-OK.pdf>



Monitorimi i Medias mbi Dhunën ndaj Grave në Zgjedhjet në Shqipëri

Ky studim i monitorimit të medias kishte për qëllim:

- Të identifikoj format kryesore të VAWE që lehtësohen ose përforcohen nga transmetimi, shtypi, online dhe mediat sociale në Shqipëri dhe
- Të jap informacion mbi paragjykimet gjinore në mbulimin mediatik gjatë zgjedhjeve.

Gjetjet bazohen në një analizë sasiore dhe cilësore të një kampioni të transmetimeve televizive përkatëse dhe artikujve të botuar në median e shkruar shqiptare dhe në portalet e lajmeve online, si dhe në postimet në mediat sociale nga faqet zyrtare të mediave sociale të partive politike dhe politikanëve individualë. Mediat e monitoruara përfshinin: 12 kanale televizive lajmesh, 20 gazeta dhe revista, 20 portale online dhe 14 faqe zyrtare në Facebook dhe janë realizuar gjatë periudhave të mëposhtme:

- Muaji para zgjedhjeve (25 mars – 24 prill 2021)
- Dita e zgjedhjeve dhe periudha paszgjedhore (25 prill – 31 gusht 2021)
- Periudha e formimit të kabinetit të ri të ministrave (1 – 25 shtator 2021).

Ky studim, i kryer nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, me mbështetjen e UN Women në Shqipëri, përpiket të eksplorojë rolin e medias në promovimin e barazisë gjinore në një kontekst të karakterizuar nga rënia e gazetarisë së bazuar në letra dhe kufizimet e COVID-19. mbi

raportimin. Më tej, ai kërkon të identifikojë nëse dhe si media (veçanërisht media online dhe dixhitale) lehtëson dhunën ndaj grave në proceset politike dhe gjatë zgjedhjeve.

Fëmijët jashtë shkollës në Shqipëri

U-Raporti 2021 - qëllimi kryesor: *Promovimi i përdorimit të U-Raportit të Ballkanit Perëndimor tek të rinjtë 15-24 vjeç dhe ndihma në rritjen e shkallës së angazhimit, përfshirë të rinjtë e vështirë për t'u arritur.*

Që nga 16 maji 2018 Shqipëria, Mali i Zi dhe Kosova janë pjesë e komunitetit U-Raport nën kornizën U-Raport për Ballkanin Perëndimor që përfaqëson një përpjekje unike të përbashkët për të adresuar çështjet e të rinjve në një kontekst nën-rajonal. U-Raport është një mjet dixhital falas dhe anonim, i krijuar nga UNICEF Global që ndërvepron me të rinjtë e moshës 15 vjeç e lart, (me fokus në moshat 15 deri në 24 vjeç), të cilët regjistrohen për t'u bërë U-Reporter përmes sondazheve të thjeshta të dërguara nëpërmjet Viber (së shpejti do të mund të përdorin Facebook Messenger dhe WhatsApp).

Kjo platformë synon të adresojë sfidat e shprehjes së shqetësimeve të të rinjve në proceset e politikave dhe zgjidhjet veçanërisht në nivel lokal. U-Raport promovon dialogun, lirinë e shprehjes dhe u jep të rinjve platformën dhe zërin për të marrë pjesë aktive dhe për të ndihmuar në formimin e zhvillimit të politikave dhe për t'u bërë më të informuar për çështjet që janë të rëndësishme për ta, në mënyrë që ata të mund të bëjnë ndryshime në komunitetet e tyre. Edhe pse në këtë platformë, rreth 8000 të rinj kontaktohen me materiale promovuese në U-Raport dhe rreth 3000 të rinj angazhohen me sondazhet e ndryshme të promovuara gjatë gjithë vitit.

Qytetarë dhe Administratë publike për një qeverisje të mirë vendore



Qëllimi: Përmirësimi i llogaridhënies dhe transparencës në nivel të qeverisjes vendore nëpërmjet angazhimit qytetar.

Grupi i synuar: Qytetarët (gratë/vajzat, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, shoq. Civile), administrata publike, drejtues dhe politikanë. Projekti po aplikohet në Bashkinë Dibër dhe Bulqizë.

Aktivitetet: 1-Takime në bashkitë pilot për prezantimin e projektit. 2-Hartimi dhe përgatitja e instrumentave matës (pyetsorëve). 3-Realizimi i publikimeve si fletëpalosje 200 copë, postera 20 copë dhe 1 banner. 4-Ditë të hapura të informimit të publikut të gjerë (nga një aktivitet për secilën bashki). 5-Realizimi i 4 workshopeve (2 për secilën bashki). 6-Realizimi i 4 takimeve konsultuese (2 për secilën bashki). 7-Realizimi i 2 takimeve përmblyëse për marrjen e vendimeve (nga 1 për secilën bashki). 8-Mbledhja e përpunimi i të dhënave dhe nxjerrja rezultateve e konkluzioneve.

Rezultatet:

1-Qytetarët janë më të informuar përsa i përket formave të informimit publik (IP) dhe zbatimit nga bashkia të ligjit „Për të drejtën e informimit publik“, programin e transparencës (PT) dhe elementët e tij përbërës si dhe reformën e administratës publike (RAP).

2-Administrata publike e qeverisjes vendore sensibilizohet dhe është më e përgjegjshme ndaj prioriteteve, nevojave, propozimeve, sugjerimeve të publikut.

3-Ka një rigjallërim të angazhimit qytetar i cili do të ndikojë në një vendimmarrje të qeverisjes vendore bazuar në mendimet, sygjerimet dhe propozimet e tij.

4- Nxjerrja e rezultateve konkrete përmes zhvillimit të aktiviteteve dhe përdorimit të instrumenteve matës (100 pyetsorëve dhe vidiove për eksperiencat e qytetarëve me administratën publike) .

Aktivitetet kryesore, rezultatet e projektit dhe një raport i shkurtër do të bëhen publike me fotot përkatëse në faqen e Observatorit www.observator.org.al dhe fb. <https://www.facebook.com/observator.org.al> Publikimi i fletëpalosjes në: <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2022/02/Fletpalosje-fin.pdf>

Disa nga gjetjet e projektit janë si më poshtë:

- Realizimi i vidiove të publikut për eksperiencat e tyre me administratën publike ishte një përvojë e re që nxori në pah nevojat e qytetarëve, problematikat e tyre dhe efektivitetin e administratës publike.
- 27% e të intervistuarëve në bashkinë Dibër dhe 47% në bashkinë Bulqizë preferojnë zyrat e administratës si formë më e mirë e qasjes në informacion.
- 74% e të intervistuarëve në bashkinë Dibër dhe 60% në bashkinë Bulqizë janë shprehur se nuk janë në dijeni të Programit të Transparencës së bashkisë.
- Në lidhje me pyetjen mbi efektivitetin e zyrave të bashkisë 54% e të intervistuarëve në bashkinë Dibër dhe 61% në bashkinë Bulqizë mendojnë se janë *efektive* ndërsa 28% e tyre në bashkinë Dibër dhe 20% në bashkinë Bulqizë mendojnë se janë *pak efektive*.
- Për pyetjen mbi efektivitetin e faqes zyrtare të bashkisë 46.5% e të intervistuarëve në bashkinë Dibër mendojnë se është *pak efektive*, 22.5% *aspak efektive* dhe 22% *efektive*. Në bashkinë Bulqizë 50% mendojnë se është *pak efektive* dhe 42% *efektive*.

Riintegrim i qëndrueshëm me bazë komuniteti i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria

Përshkrimi i programit: Qëllimi kryesor i programit "Riintegrimi i qëndrueshëm në komunitet i shtetasve shqiptarë të kthyer nga Siria" është të mundësojë rehabilitimin dhe riintegrimin e qëndrueshëm dhe efektiv të burrave, grave dhe fëmijëve shqiptarë që kthehen nga Siria.

Objektivat : Ndërhyrja jonë konsiston në tre komponentë kryesorë: forcim kapacitetesh, bashkëpunim ndërsektorial dhe fuqizim i komuniteteve, të cilat synojnë të krijojnë një mjedis mundësues për institucionet dhe profesionistët e vijës së parë dhe njëkohësisht të forcojnë kohezionin social dhe qëndrueshmërinë ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

- Komponenti i parë synon të përmirësojë kapacitetet, njohuritë dhe aftësitë e profesionistëve të vijës së parë dhe të institucioneve në lidhje me praktikën e riintegritimit dhe rehabilitimit (R&R) Ky komponent përfshin një sërë aktiviteteve si: kryerja e hulumtimit për të identifikuar kërcënimet aktuale të ekstremizmit të dhunshëm; trajnimi i profesionistëve të vijës së parë dhe aktorëve lokalë mbi praktikën dhe hapat që nevojiten për të garantuar shërbime efikase, përmirësimi i mekanizmave të referimit, identifikimi, raportimi dhe parandalimi i rasteve të radikalizimit nga aktorët vendorë.
- Komponenti i dytë ka për qëllim të forcojë bashkëpunimin dhe partneritetet ndërmjet institucioneve të përfshira në procesin e hartimit të politikave dhe ofrimit të shërbimeve të riintegritimit dhe rehabilitimit. Kjo do të arrihet përmes advokimit për prioritizimin e çështjeve që lidhen me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm (EDH) në agjendë politike dhe përmirësimin e koordinimit ndërinstitutional.
- Së fundmi, komponenti i tretë synon të kontribuojë në riintegrimin e të kthyerve në komunitetet pritëse; pranueshmërinë e tyre nga komuniteti dhe rritjen e kohezionit shoqëror në tërësi. Ky komponent përfshin një sërë aktiviteteve, si kurse profesionale dhe programe praktikash të paguara për të rikthyerit dhe familjarët e tyre; mbështetjen e nismave komunitare, aktiviteteve me liderët fetarë dhe të komunitetit; si dhe aktivitete kulturore, edukuese, argëtuese dhe sportive me të rikthyerit dhe komunitetet lokale.

Info për projektin gjëndet në faqen e Observatorit: www.observator.org.al tek publikimet

<https://observator.org.al/wp-content/uploads/2022/02/Reintegration-Infosheet-3.pdf>



Rezultatet:

- Institucionet dhe profesionistët e vijës së parë përmirësojnë kapacitetet (njohuritë dhe aftësitë) për të ofruar shërbime rehabilitimi dhe riintegrimi
- Partnerët mediatikë përmirësojnë kapacitetet në raportimin e çështjeve që lidhen me EDH dhe praktikën e R&R
- Aktorët institucionalë përftojnë njohuri të përditësuara mbi nevojat e komuniteteve dhe kërcënimeve nga EDH
- Punonjësit socialë dhe psikologët përftojnë njohuri dhe aftësi për të mbështetur fëmijët, të kthyerit dhe familjet e tyre
- Institucionet dhe profesionistët e vijës së parë përmirësojnë bashkëpunimin ndërsektorial dhe efektiv në kuadrin e riintegritimit dhe rehabilitimit të të rikthyerve

- Institucionet dhe profesionistët e vijës së parë priorizojnë politikat dhe praktikat e R&R në agjendat e tyre
- Personat e kthyer dhe familjet e tyre integrohen në komunitetet pritëse, të cilat shprehin nivel më të reduktuar të stigmatizimit dhe pranueshmëri më të madhe
- Personat e kthyer dhe familjet e tyre përftojnë trajnime profesionale dhe aftësi biznesi për t'u integruar në jetën socio-ekonomike

Avancimi i Mbrojtjes dhe Kujdesit të Fëmijëve në Shqipëri 2019-2021

Vlerësimi i Programit të Mbrojtjes së Fëmijëve “Përparimi i Mbrojtjes dhe Kujdesit të Fëmijëve në Shqipëri 2019 -2021”

Ky vlerësim është zhvilluar në përgjigje të kërkesës së dhënë në Termat e referencës, që synon të përvijojë:

- Metodologjinë e propozuar për vlerësimin
- Afati kohor dhe shpërndarja e ditëve të punës për dorëzues
- Informacion përmbledhës i ekipit të propozuar për të kryer vlerësimin.

Metodologjia e propozuar e vlerësimit

Qëllimi i vlerësimit është i dyfishtë, për të:

- Të forcohet përgjegjshmëria e Save the Children ndaj donatorit të Programit dhe palëve të interesuara kombëtare.
- Të nxjerrë mësimet dhe të japë rekomandime konkrete se si të përmirësohen programe të ngjashme në të ardhmen.

Objekti i vlerësimit është zbatimi i programit “Përparimi i Mbrojtjes dhe Kujdesit të Fëmijëve në Shqipëri 2019 -2021” (më tej i referuar si Programi), i zbatuar nga Save the Children në Shqipëri. Objekti i vlerësimit është i gjithë portofoli programor i Programit, me objektiv gjeografik në Gjirokastrë, Mat, Sarandë, Shkodër, Tiranë.

Objektivat specifike të vlerësimit janë:

1. Vlerësoni rezultatet e Programit kundrejt aktiviteteve të planifikuara, duke shqyrtuar efikasitetin, efektivitetin, rëndësinë, qëndrueshmërinë, koherencën dhe ndikimin e tij.
2. Shqyrtoni se si programi ka integruar çështjet ndërsektoriale si promovimi i barazisë gjinore dhe të drejtat e fëmijëve.
3. Kapni mësimet e nxjerra, praktikat e mira dhe rekomandimet mbi të cilat Save the Children dhe palët e interesuara mund të bazohen për programimin e ardhshëm.

» PARTNERËT E OBSERVATORIT

Kontributi i Partnerëve

TITULLI PROJEKTIT	PERIUDHA E ZBATIMIT	DONATORI
Për krijimin, koordinimin, dhe zgjerimin e platformës mbrojtëse të shoqërisë civile për çështjet e ICPD dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm	Janar – Dhjetor 2021	UNFPA
Trajtimi i shkaqeve themelore të diskriminimit ndaj grave në Shqipëri	Mars 2020 – Tetor 2021	BCCD
Monitorimi i Medias mbi Dhunën ndaj Grave në Zgjedhjet në Shqipëri	Prill 2021 – Tetor 2021	UN Women
Fëmijët jashtë shkollës në Shqipëri	Maj – Dhjetor 2021	UNICEF
Qytetarë dhe Administratë publike për një qeverisje të mirë vendore	Qershor 2021 – Mars 2022	IDM Albania - WeBER

Riintegrim i
qëndrueshëm me bazë
komuniteti i shtetasve
shqiptarë të kthyer nga
Siria

Qershor 2021 –
Nëntor 2023

IDM-GCERF

Avancimi i Mbrojtjes
dhe Kujdesit të
Fëmijëve në Shqipëri
2019-2021

Nëntor – Dhjetor 2021

Save the Children